

Titulli: Aktiviteti i Organeve Sigurimit të Shtetit në Burgje dhe Kampe, Gjatë Regimit Komunist.

PhD. Femi Sufaj

BIO

Ka lindur në Dibër më 29.05.1960 dhe banon në Tiranë. Në vitin 1983 ka përfunduar studimet në degën e historisë dhe gjeografisë në Institutin e Lartë Pedagogjik “Luigj Gurakuqi” me rezultate të shkëlqyera. Në vitin 2002-2004 ka kryer studimet në ciklin e dytë universitar për histori në Fakultetin Histori-Filologji Universiteti i Tiranës me temë “Vështrim historik mbi dënimet penale 1912-1944”. Në vitet 2008-2012 ka kryer studimet në ciklin e tretë pas universitar në Universitetin e Tiranës, Fakulteti Histori-Filologji, ka fituar gradën Doktor, Tema: “*Sistemi i ndëshkimeve gjatë regjimit komunist 45-90*” Drejtues: Prof.Dr Ajet Shahu. Z. Sufaj, ka kryer studimet në ciklin e parë universitar në Akademinë e Policisë në vitin 1993-1997. Ka shërbyer në administratën publike, për rreth 10 vite në fushën e arsimit dhe mbi 30 vite në sistemin e burgjeve në detyra të ndryshme të nivelit të menaxhimit. Aktualisht është në pozicionin Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm i Burgjeve. Përveç funksioneve administrative, Femi Sufaj është autor i disa studimeve historike dhe pjesëmarrës në disa konferenca brenda dhe jashtë vendit lidhur me të drejtat e njeriut. Ai ka një profil që kombinon detyrën administrative me studimin akademik të historisë së sistemit penal dhe burgjeve në Shqipëri

Abstrakt

Organet e sigurimit të shtetit nga ditët e para të funksionimit deri në fundin e ekzistencës së tyre, kanë patur si objekt të punës mbikëqyrjen, kontrollin, hetimin dhe dërgimin në gjykata për ridënim të shtetasve të burgosur dhe internuar, krahas aktiviteteve të tjera që lidheshin me sigurinë e brendshme dhe të jashtme të shtetit dhe ruajtjen e pushtetit. Ndryshe nga eksperiencat bashkëkohore të vendeve perëndimore, ku sistemi i rehabilitimit është i ndarë nga sistemi i policies dhe hetimit, në shtetet komuniste ka funksionuar një zinxhir i institucioneve të diktaturës të cilët realizonin ndjekjen, hetimin, zbulimin ridënimin gjatë ekzekutimit të vendimeve penale, në burgje dhe kampe internimi dhe pas lirim, në shoqëri, në ndërmarrje, në kooperativa e kudo. Strukturat e sigurimit të shtetit në burgje, kampe pune dhe në kampe të internimit kanë qenë të pavarura nga komandat e këtyre institucioneve dhe ishin vendim marrëse në të gjitha proceset e punës në funksion të realizimit të qëllimeve edhe objektive të tyre. Kështu në një proces për lirim me kusht, ose transferim të një të burgosuri, për zbatimin e një regjimi më poshtërues e çnjerëzor, ose për disa lehtësi të pa konsiderueshme, për një vizitë nga familja apo për të postuar një letër asaj, të gjitha këto dhe të tjera nuk mund të zbatoheshin pa konfirmimin me shkrim të punëtorit operativ.

Për shkak se popullata e burgjeve dhe kampeve kishte të burgosur politik, të quajtur “armiqtë e popullit”, me përbërje nga kleri dhe intelektualë, anëtarë të organizatave antikomuniste, tregtarë dhe pronarë, shtetas të cilët kishin të afërmit e tyre të arratisur, ish drejtues të lartë të shtetit dhe ish anëtarë të partisë, të cilët ishin dënuar si tradhtarë, kjo bënte që burgjet të konsideroheshin si

objekte të rëndësisë së veçantë. Edhe në kushte izolimi dhe keqtrajtimi, “armiqtë e popullit” vazhduan të konsiderohen rrezik potencial për regjimin, kështu kanë qenë subjekt i vazhduar i kontrollit dhe hetimit nga ana e organeve të sigurimit të shtetit.

Në raportin e vitit 1959 të Degës së Kampeve dhe Burgjeve, thuhet se aktiviteti armiqësor në kampe e burgje është përqëndruar në agjitacion e propogandë kundër pushtetit popullor me tendenca arratisje dhe organizimi. Elementë që zhvillojnë këtë aktivitet janë kryesisht të prejardhur nga organizata kunderrevolucionare, si balliste, zogiste, pjestarë të Ballit, indipedentë dhe element të tjerë. Për të zbuluar dhe shpartalluar këtë veprimtari, përveç masave agjenturore operative që janë marrë nga organet e sigurimit të shtetit kemi marrë masa për transferimin e të dënuarve, nga Reparti 309 Thumanë, në Burgun e Burrelit, të Tiranës dhe të Vlorës. Në këtë mënyrë kemi mundur të parandalojmë punën e elementit armik. Një punë e mirë është bërë në studimin e bashkëpunëtorëve që janë nëpër kampe e burgje, në bashkëpunim me degën dhjetë, kemi bërë transferimin e tyre. Në këtë mënyrë është kontrolluar veprimtaria e elementit armik dhe janë shpërndarë ata që kanë patur tendenca arratisje. Edhe në raportin e vitit 1962, ngrihet i njëjti shqetësim nga ana e administratës së burgjeve. Në raportin me titull “Veprimtaria armiqësore nëpër burgje”, thuhet: “Përfaqësues të Ballit, Legalitetit, Socialdemokracisë, të dënuar për agjitacion e propogandë kundër pushtetit popullor, po e paraqesin situatën të paqëndrueshme, gjendjen ekonomike të vështitë dhe aludojnë se do të ketë ndërhyrje nga jashtë. Po nxisin arratisje duke thënë se kalimi jashtë kufive të atdheut do tju krijojë kushte për një luftë efikase kundër pushtetit popullor.

Veprimtaria e organeve të sigurimit brenda burgjeve dhe kampeve krahas vëzhgimit, hetimit dhe dërgimit të burgosurve në gjykata për ridënim, ka qenë edhe veprimtari operacionale që konsistonte në organizimin e kombinacioneve mërpërmjet bashkëpunëtorëve për nxitje dhune, arratisje, përçarje e tje, në funksion të forcimit të kontrollit mbi të burgosurit.

Fajlë kyçe: *sigurimi i shtetit, burgje dhe kampe, bashkëpunëtorë, ridënim*